

5 D Konstruksion sh.p.k

*(Vlerat janë në Lek)*

---

**5D Konstruksion sh.p.k**  
**Shenimet Shpjeguese per**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021**

## 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "5D Konstruksion" Shpk është regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me date 22.01.2016. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" me NIPT L61322023P.

Me Vendim Asambleje Nr 57 date 01.12.2021 shoqëria ka ndryshuar emertim nga "V.A.S Konstruksion" shpk në "5D Konstruksion" Shpk.

Kapitali themeltar i shoqërisë "5D Konstruksion" Shpk është 1,000,000 Lekë, i ndarë në 1 kuotë. "5D Konstruksion" sh.p.k është një shoqëri shqiptare me ortak të vetëm z. Nestor Muhamellari

Administrator i Shoqërisë është z. Nestor Muhametllari.

Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga " Andon Zako Çajupi", Qendra Zayed Bussiness Center, seksioni 3 C, D, kati III-të .

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie ka të bëjë me veprimtarinë në fushën e ndertimit të përgjithshëm; veprimtari në fushën e projektimit dhe zbatimit; veprimtari në fushën e ujësjellës – kanalizimeve; supervizionit dhe ndertimit të linjave elektrike mbitokesore dhe nentokesore për energjinë elektrike dhe telekomunikacioni dhe tensioni të mesëm (kabinat elektrike).

### 1. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

#### 1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 1.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.



#### 1.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 1.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat.

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

### 2.5 Vlerësim dhe gjykime (vazhdim)

aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### 1.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### 1.5.2. Provizionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.



## 1.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 2. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 2.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

## 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
EUR/LEK	120.76	123.70
USD/LEK	106.54	100.84

### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të



ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabile.



### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç' regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

##### Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### Kapitali

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të



përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4. Aktive afatgjata materiale

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i

pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:



Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Toka	Nuk amortizohet	0 %
Ndërtime dhe instalime	Vlerë e mbetur	5 %
Makineri e paisje	Vlerë e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlerë e mbetur	20 %
Paisje kompjuterike	Vlerë e mbetur	25 %
Mobilje e orendi	Vlerë e mbetur	20 %
Të tjera	Vlerë e mbetur	20 %

#### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### 3.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

### 3.6 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare, të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.7 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabel të tatimit.





për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15%, (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### 4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në bankë	31,707,357	60,009,690
Llogari rrjedhëse		
Mjete monetare në arkë	930,246	1,907,947
	<u>32,637,602</u>	<u>61,917,637</u>

#### 5. Llogaritë e arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Klientë	224,994,052	229,630,722
	<u>224,994,052</u>	<u>229,630,722</u>

#### 6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Detyrime doganore	321,890	5,048
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	306,988	306,988
	<u>628,879</u>	<u>312,036</u>



**7. Inventari**

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Lend e pare materiale	3,425,115	5,944,548
Punime ne proces	73,111,336	
	<u><u>76,536,451</u></u>	<u><u>5,944,548</u></u>

**8. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzime të periudhave të ardhshme	59,000,276	20,671,158
Parapagime	237,382	4,098,052
	<u><u>59,237,658</u></u>	<u><u>24,769,210</u></u>



9. Aktive afatgjata materiale

	% e Amortizimit	Amortizimi i fillshëm		Amortizimi i akumuluar deri më 31.12.2020		Amortizimi i akumuluar deri më 31.12.2021		
		Vlera Fillestare	Vlera e mbetur deri më 31.12.2020	Shtesa 2021	Dalje 2021	Amortizimi i Vitit 2021	Vlera e mbetur deri më 31.12.2021	Amortizimi i akumuluar deri më 31.12.2021
Emertimi i Aktiv të Qendrueshme								
Koncensione dhe të drejta të ngjashme, licensa	15%	701,812	507,059	0	0	76,059	431,000	270,812
Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	20%	5,931,615 18,129,40	1,891,898	2,987,912	0	680,228	4,199,582	1,732,033
Mjete transporti	20%	7	10,681,922	4,022,826	0	2,631,404	12,073,343	6,056,064
Mobilje e orendi	20%	1,634,681	1,226,986	58,598	0	253,688	1,031,896	602,785
Pajisje Inf. kompjuterike	25%	1,422,379 63,106,20	598,528	353,302	0	202,264	749,566	672,814
Troje	0%	0	0	63,106,200	0	0	63,106,200	0
<b>Totali</b>		<b>90,926,09</b> 4	<b>14,906,393</b>	<b>70,528,838</b>	<b>0</b>	<b>3,843,643</b>	<b>81,591,587</b>	<b>9,334,508</b>



**10.Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Furnitore	258,076,529	175,654,993
	<u><b>258,076,529</b></u>	<u><b>175,654,993</b></u>

**11.Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	570,687	407,427
Tatimi mbi të ardhurat nga Punësimi	98,210	47,938
Tatim mbi fitimin	1,547,755	8,098,980
Tatim në burim	10,588	0
TVSH për t'u paguar	100,360	290,553
	<u><b>2,327,600</b></u>	<u><b>8,844,898</b></u>

**12.Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Te pagueshme ndaj punonjesve	2,979,881	1,690,461
Te pagueshme ndaj ortakeve	35,442,577	6,505,177
Arkitime ne avance per porosi	8,511,800	
	<u><b>46,934,258</b></u>	<u><b>8,195,638</b></u>

**13.Hua afatshkurtra**

Huatë afatshkurter për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Qera Financiare-Leasing	747,193	123,767
	<u><b>747,193</b></u>	<u><b>123,767</b></u>



**14. Kapitali**

Më 31 dhjetor 2021 kapitali i regjistruar i shoqërisë është 1,000,000 Lekë (2020: 1,000,000 Lekë), i ndarë në 1 kuotë me vlere nominale 1,000,000 Lekë.

	31 dhjetor 2021				31 dhjetor 2020		
	Kuotat	Vlera nominale	Në %		Kuotat	Vlera nominale	Në %
Nestor Muhametllari	1	1,000,000	100%	Nestor Muhametllari	1	1,000,000	100%
	<b>1</b>	<b>1,000,000</b>	<b>100%</b>		<b>1</b>	<b>1,000,000</b>	<b>100%</b>

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kapitali i nenshkruar	1,000,000	1,000,000
Rezerva ligjore	3,604,711	3,604,711
Fitimi/(humbja) e pashperndare	100,056,535	33,244,858
Fitimi/(humbja) e periudhes	104,034,411	106,811,679
	<b>208,695,659</b>	<b>144,661,248</b>

**15. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhura nga punime ndërtimi për të tretë	498,823,885	419,750,196
Të ardhura te tjera	30,000	117,990
Të ardhura nga shitja e materialeve	8,756,531	31,680
Fitime nga kursi i këmbimit	135,157	73,778
Të ardhura nga interesa kreditor	12	347
	<b>507,745,584</b>	<b>419,973,991</b>



**Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:**

Të ardhurat e deklaruara në FDP e shoqërisë ndryshojnë nga të ardhurat e pasqyruara në PASH.  
 Ndryshimet lidhen me:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
<b>Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH</b>	<b>507,580,415</b>
<b>Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH</b>	<b>507,580,415</b>
Të ardhura nga punime ndërtimi për të tretë	589,823,885
Të ardhura nga shitja e materialeve	8,756,531
<b>Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhura ne PASH</b>	<b>507,580,415</b>
Të ardhura nga interesa kreditor	12
Fitim nga kembimet valutore	135,157
Demshperblim siguracion auto	30,000
<b>Total te ardhura deklaruar ne FDP e Tatim Fitimit</b>	<b>507,745,584</b>

**16.Lënda e parë, shërbime dhe materiale të konsumueshme.**

Materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Blerje materiale të para	193,980,405	63,747,821
Materialë ndihmës	956,106	250,935
	<b>194,936,511</b>	<b>63,998,756</b>
<i>Te tjera shpenzime</i>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Blerje,energj,avull,uje	197,062	102,814
Shpenzime veshje pune	57,853	31,950
Shpenzime Karburant	3,099,970	2,561,000
Blerje /Shpenzime të tjera		140,668
Shpenzime nga punime per vete		117,990
	<b>3,354,886</b>	<b>2,954,422</b>



**17. Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Pagat dhe shpërblimet e personelit	23,441,806	12,608,085
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	3,928,362	2,105,149
	<b>27,370,168</b>	<b>14,713,234</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2021 është 43 . (2020 : 43).

**18. Shpenzime konsumi dhe amortizimi**

Shpenzime konsumi dhe amortizimi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	3,843,643	2,220,246
	<b>3,843,643</b>	<b>2,220,246</b>

**19. Shpenzime te tjera shfrytezimi**

Shpenzime te tjera shfrytezimi detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
Nenkontraktme	129,105,769	195,493,950
Qera	3,191,630	1,307,476
Mirembajtje riparime	1,495,079	2,304,176
Shpenzime Transporti per blerje	1,215,743	123,583
Sigurime	580,925	1,018,078
Shpenzime Administrative	313,394	313,342
Shpenzime Sherbime Noterise	1,279,397	325,868
Shpenzime Konsulenca te jashtme	802,427	229,711
Shpenzime Analiza, Teste, Certifikime	371,697	180,370
Subvencione te dhena	901,077	
Shpenzime Depozitim Mbetje Ndertimore	4,517,419	766,940
Publicitet, reklama	97,993	60,547
Shpenzime per Transferime, udhëtime, dieta	6,213,852	6,254,560
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	254,685	187,542
Shpenzime për shërbimet bankare	207,631	114,982
Taksa dhe tarifa vendore	1,174,417	651,600
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	950,540	141,752
Gjoha dhe dëmshpërblime	2,093,638	6,981
Të tjera sherbime	99,621	783,593
	<b>154,866,937</b>	<b>210,265,050</b>



**20. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit dhe shpenzime për interesa nga aktiviteti tregtar balanca e së cilave paraqitet si më poshtë: 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime për interesa	55,673	31,926
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	387,136	103,310
	<b>442,809</b>	<b>135,236</b>

**21. Tatimi mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>122,930,632</b>	<b>125,687,046</b>
Të ardhura jo tatimore		
<b>Total shpenzime të panjohura</b>		
Penalitet, gjoba e dëmshperblime	2,093,638	6,981
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	950,540	141,752
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<i>125,974,810</i>	<i>125,835,779</i>
<b>Tatim fitimi @15%</b>	<b>18,896,222</b>	<b>18,875,367</b>
<b>Rezultati i vitit</b>	<b>104,034,411</b>	<b>106,811,679</b>

**22. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Financier  
Jonida Hoxhaj

Administrator  
Nestor Muhamedhar

